



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

OSNOVNI SUD PRIŠTINA - OGRANAK GRACANICA

Broj predmeta: 2024:023885

Datuma: 25.10.2024

Broj dokumenta: 06349642

NE EMER TE POPULLIT

K.nr.28/24

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-DEGA GRAQANICE - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE, në përbërje të gjyqtarit individual Siniša Borisavljević, me bashkepunetoren profesionale Pranvera Ismaili Zhinipotoku, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit **G. Z.** nga f..... K.Shtime, për shkak të veprës kundërvajtëse nga neni 41.3 dhe neni 255, par. 2, të LRRTRR, (Ligji nr. 05/L-088), më datë 10.09.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

Te pandehurit **G. Z.**, i biri i **B.** i lindur mw dt..... ne Ferizaj tani me vendbanm ne f....., rruga, Haxhi Halimi, ku edhe jeton, Jurist, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, i padënuar më parë dhe nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër ndaj tijë, me **nr.letnj.**shqiptarë - Shtetas i Republikës së Kosovës

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s e

Sepse: Me daten rreth ores h ne fshatin Cagllavice tek aksidenti kishte ardhur kur vozitesi i vetures -A- ishte duke lëvizur nga drejtimi Qagllavic-Llapnasell dhe me te arritur përball spitalit Fati im kishte marr veprim te pasigurt (kthim majtas me qellim hyrje tek spitali) dhe gjate këtij veprimi ishte goditur me automjetin -B- i cili ne ato momente vinte nga drejtimi Llapnasell-Qagllavice. Me kete rast shkaktohet aksident trafiku me deme materiale dhe lendime trupore

- me çka ka kryer veprën kundërvajtëse nga neni 41.3 dhe neni 255, par. 2, të LRRTRR, (Ligji nr. 05/L-088),për rrjedhojë gjykata duke vendosur në kuptim të nenit në fjalë si dhe në bazë të neneve 3, 7, 8, 9, 13, 27, 29 dhe 35 të ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, ky

Aktgjykim i shqiptohet të pandehurit ku:

D Ë N O H E T

ME DËNIM ME TË HOLLA në shumë prej 300 € (treqindeuro), për veprën e kryer e cila i vihet në barre si më lartë.

Miratohet që të paguhet gjyba në dy keste të barabarta prej **150 euro** secila, në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse nuk e paguan në afatin e përcaktuar, do të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e Ligjit për përmbarim.

Gjoben e shqiptuar e pandehura do ta paguaj në afate prej **15** dite nga dita e kur aktgjykimi të merre formën e prërë, nëse kërcënim të përmbarimit në përputhje me dispozitat LPP-s.

I pandehuri, obligohet që në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën prej **10 € (dhjete euro)** në afatin e njëjtë.

Nga një kopje të këtij aktgjykimi ti dërgohet të pandehurit, ushtruesit të kërkesës dhe të demtuarit.

A r s y e t i m i

Stacioni Policor-NJKRR në Prishtinë e, kësaj Gjykate i ka parashtruar Kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse **nr.2023-AR-3957 datë 15.12.2023** kundër të pandehurit të lartëshënuar, për shkak të veprës kundërvajtëse e pershkruar sipas dispozitave ligjore.

Gjyqtari, filloi procedurën kundërvajtëse, marrjes në pyetje të pandehurit i cili në deklaratën-mbrojtjen e tij me dt 04.09.2024, në tërësi pranoi veprën kundërvajtëse e cila i ngarkohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi andaj për këtë nuk pati nevojë që të administrohen prova tjera

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, deklaratës së të pandehurit si dhe kërkesën e stacionit policor, gjyqtari i çështjes erdhi në përfundim se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha elementet e veprës kundërvajtëse, ashtu që të pandehurin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e shqiptimit të dënimit, gjyqtari muarr parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 35 të Ligjit për Kundërvajtje e sidomos peshën e veprës kundërvajtëse dhe pasojat, rrethanat nën të cilat është kryer kundërvajtja, shkallën e përgjegjësisë dhe tiparet personale të tij, pranimin e fajsisë, është penduar dhe ka premtuar se nuk do t'a përsëris mënjë veprim të tillë si dhe faktin se deri me tani nuk ka qene i denuar, andaj bazuar në të gjitha këto rrethana, të pandehurit iu shqiptua një dënim i tillë me bindje se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor.

Në bazë të të gjitha te cekurave më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-DEGA GRAQANICE
Departamenti i pergjithshem, Divizioni per kundervajtje
K.nr. 28/24 nga 10.09.2024

Bashkepunetore Profesionale
Pranvera Ismaili Zhinipotoku

Gjyqtari
Siniša Borisavljević

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtroj ankesë paraqitësi i kërkesës dhe i pandehuri, në afat prej **8 ditësh** nga dita e pranimit të aktgjykimit në Gjykatën e Apelit-Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.